

URDHËR
Nr. 714, datë 3.4.2013

PËR PËRCAKTIMIN E SHKELJEVE TË TJERA TË LIGJIT NR. 9367, DATË 7.4.2005 “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të pikës 1 germa “e” të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 86/2012, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

URDHËRON:

Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në pikën 1 germa “e” të nenit 44 të këtij ligji, në rastet kur:

1. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, i ngritur në zbatim të nenit 41/2 pika “b” të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, nuk dokumenton dhe regjistron në regjistrin e konfliktit të interesit, të dhënat e kërkuara në nenin 11 të këtij ligji lidhur me rastet e konfliktit të interesave në institucionin publik përkatës.

2. Zyrtari, eprori apo struktura përgjegjëse në institucionin epror, në kundërshtim me kërkesat e nenit 37/9 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, nuk njofton në kohë Inspektoratin e Lartë, mbi masat e marra rast pas rasti në kompetencë të tyre, për trajtimin apo zgjidhjen e konfliktit të interesit sipas përcaktimit të bërë në nenin 37 të këtij ligji.

3. Zyrtari/struktura përgjegjëse e institucionit publik, sipas përcaktimit të bërë në ligjin organik dhe aktet nënligjore respektive, nuk ndërmerr masat e nevojshme për rregullimin e pasojave juridike të akteve të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 40/1 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative.

4. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, nuk përmbush në afatet e caktuara detyrimet ligjore të përcaktuara në nenin 42/3, paragrafi i dytë të këtij ligji, si dhe detyrat e lëna nga Inspektorati i Lartë, për problematikat që rezultojnë nga kontrollet e ushtruara mbi veprimtarinë dhe zbatimin e ligjit.

5. Zyrtari/struktura përgjegjëse, sipas organizimit dhe funksionimit të institucionit publik, nuk përmbush detyrimin ligjor, të përcaktuar në nenin 42/3, paragrafi i tretë, për njoftim paraprak të Inspektoratit të Përgjithshëm në rastet e emërimit, lëvizjes apo largimit nga funksioni të autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME
Zana Xhuka